

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	O
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	16:00-17:30, E hënë S-U
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Asoc. Remzije Istrefi
Detajet kontaktuese:	remzije.istrefi@uni-pr.edu Konsultimet : E hënë 15:00-16:00
Përshkrimi i lëndës	<p>Studentët që ndjekin këtë kurs duhet të kenë njohuri themelore për të drejtat e njeriut dhe mjedisin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar sa i përket mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave të njeriut.</p> <p>Lënda në fjalë përmban çështje të historisë së të drejtave të njeriut, instrumentet ndërkombëtare që konsistojnë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, juridiksioni i Gjykatave ndërkombëtare, Intervenimet ndërkombëtare, globalizimi dhe të drejtat e njeriut, të drejtat e grupeve të veçanta shoqërore siç janë ato të grave, fëmijëve, pakicave dhe e ardhmja e të drejtave të njeriut.</p> <p>Për të përfituar më shumë nga kursi, studentët do të njihen me edhe folës të ndryshëm nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare të cilët do të japin leksione mbi tema të veçanta të përcaktuara në planin mësimor.</p>
Qëllimet e lëndës:	Pas përfundimit të suksesshëm të kursit, studentët do të jenë në gjendje për të kuptuar dhe interpretuar instrumentet kombëtare dhe ndërkombëtare të

	drejtave të njeriut, duke përfshirë kuadrin ligjor dhe institucionet e projektuara për zbatimin e rregulloreve.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në marrjen e këtij kursi studentët do të thellojnë edhe më tej njohuritë e tyre me tema të ngjashme si më poshtë: historia të drejtave të njeriut, mjetet për zbatimin e të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe të Drejtat Ekonomike dhe Sociale, Juridiksioni i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Intervenimet dhe të Drejtat e Njeriut, të Drejtat e Njeriut dhe e Drejta Humanitare, Globalizimi dhe Përgjegjësia Transnacionale e Korporatave për të Drejtat e Njeriut, të Drejtat e Grave, të Drejtat e Fëmijëve, të Drejtat e Pakicave, dhe e Ardhmja e të Drejtave të Njeriut.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mesimdhënësin/konsultimet	2	2	4
Ushtrime në teren	5	1	5
Kollokfiume,seminare	4	4	16
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	10	2	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj	2	2	4
Totali			133
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënies përfshinë, ligjëratat, diskutime, pyetje dhe përgjigje, argumentim, prezantime të punës grupore. Komunikim instruktiv seminar/tutorial bazuar në studimet e rasteve, tekstet origjinale ligjore dhe politike, elemente të seminarit, folësit e ftuar, ekskursione, provimin përfundimtar.		

Metodat e vlerësimit:	<p>Pjesëmarrja e rregullt aktive ne klase: (20%) ju ofron një mundësi për të dhen mendimin kritik ne lidhje me temat dhe rastet e reale qe kane te bëjnë me te drejtat e njeriut’ dhe/ose;</p> <p>Hulumtimi shkencore/seminari: (80%) studenti duhet të shkruajë një ese origjinale duke hulumtuar aktivisht në temën e caktuar. Hulumtimi duhet të përfshije leximet nga materialet e kursit, të shfrytëzojë një format të duhur citimesh dhe bibliografi, dhe të demonstrojë mendimin origjinal dhe të paraqesë një tezë në një paragraf temë, të eksplorojë tezën në një mënyrë të organizuar dhe rigoroze, dhe në fund me një përfundim. Hulumtimi final, i cili duhet të jetë solide 10-14 faqe, dorëzohet në fillim të klasës së fundit.</p> <p>Vlerësimi mbi provimit përfundimtar është 80% dhe pyetjet janë të bazuara në baza cilësore/vlerësimin cilësore i pyetjeve te shtruara.</p>

Literatura	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> • TE DREJTAT E NJERIUT SIPAS JURISPRUDENCËS SE GJYKATËS EVROPIANE PËR TE DREJTAT E NJERIUT(PËRMBLEDHJE E RASTEVE), REMZIJE ISTREFI/ILIRIANA ISLAMI/QERIM QERIMI, 2019; • HYRJE NE SISTEMIN LIGJORE NE KOSOVË, ARSIM BAJRAMI, ENVER HASANI, HAJREDIN KUQI, HAXHI GASHI, ISET MORINA, AVNI PUKA, AZEM HAJDARI MIRLINDA BATALLI, REMZIJE ISTREFI,2019 . • MATERIALE TE PËRGATITURA NGA LIGJËRUESJA E LENDES
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • International Human Rights in Context: Law, Politics, Morals 3rd Edition by Henry J. Steiner (Editor), Philip Alston (Editor), Ryan Goodman (Editor) • International Human Rights Law, Eighth Edition, Rhona Smith • International law and national legislation: their relation to human rights and the protection of minorities, Jim Kim <p>Linqe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>HUDOC - European Court of Human Rights:</u> https://hudoc.echr.coe. • United Nations Human Rights System: Treaties, Mechanisms and Documents: https://www.escr-net.org/resources/united-nations-human-rights-system-treaties-mechanisms-and-documents . • A Rough Guide to the Regional Human Rights Systems : https://www.universal-rights.org/human-rights-rough-guides/a-rough-guide-to-the-regional-human-rights-systems/ . • Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: http://gjk-ks.org/.
Plani i dizajnuar i mëimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Pse të drejtat e njeriut? Konceptet kryesore: filozofia, politika, ligji, dhe historia

Java e dytë:	Relativizmi kulturore dhe natyra e të drejtave të njeriut: debati i univerzalizmit.
Java e tretë:	Strategjitë dhe mjetet për zbatimin e të normave të të drejtave të njeriut Te drejtat civile dhe politike
Java e katërt:	Strategjitë dhe mjetet për zbatimin e normave të të drejtave të njeriut Të drejtat ekonomike dhe sociale
Java e pestë:	Mekanizmat kryesore ndërkombëtare dhe rajonal për mbrojtjen e te drejtave te njeriut Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut / raste
Java e gjashtë:	Pune ne grupe Rastet e GEDNj dhe Gjykatës Kushtetuese
Java e shtatë:	Prezantues i jashtëm (Avokati i Popullit ose Përfaqësues i Organizatave te Shoqërisë Civile)
Java e tetë:	Ndërhyrja dhe të drejtat e njeriut Në çfarë rrethanash është intervenimi humanitar i duhur për mbrojtjen e abuzimeve dhe viktimave të të drejtat e njeriut?
Java e nëntë:	Mekanizmat kryesore Ndërkombëtare për gjykimin e Krimeve te Luftës / Krimet Ndërkombëtare dhe Krimet kundër njerizimit
Java e dhjetë:	Globalizimi dhe përgjegjësia e transnacionale e korporatave për të drejtat e njeriut
Java e njëmbëdhjetë:	Të drejtat e grave dhe mekanizmat kryesore vendore dhe ndërkombëtare Statusi, diskriminim, dhuna: socio- ekonomike dhe kulturore konteksti Konventa CEDAW, parimet dhe komiteti
Java e dymbëdhjetë:	Të drejtat e fëmijëve mekanizmat kryesore vendore dhe ndërkombëtare Statusi, diskriminim, dhuna, socio- ekonomik dhe konteksti kulturor

	Konventa Ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve; parimet dhe komiteti
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Të drejtat e minoriteteve Veprimet shtetërore Veprimi afirmativ Parimet dhe komiteti
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	E ardhmja e të drejtave të njeriut; sfidat dhe prospekte për avancimin e të drejtave të njeriut
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Provimi përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja në ligjerata dhe ushtrime është e detyrueshme. Studentët duhet të jenë të regullt në ligjërata dhe ushtrime. Ata inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjeratave. Profesorët dhe asistentët do të jenë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime me studentët.

Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjerate të lexojnë së paku literaturën që u është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Ata do të mbështeten gjatë gjithë kohës për të përvetësuar programin. Studentët inkurajohen të përcjellin studimet në media dhe të pyesin në lidhje me ecuritë dhe problemet ndërkombëtare dhe të hapin diskutime lidhur me to.